



SIMPOZIUM NDËRKOMBËTAR LETËRSIA E HUAJ NË SHQIPËRINË SOCIALISTE

UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

12-13 TETOR 2026



Shtyrje e afatit për abstraktet
deri më 15 gusht

- ▶ Ftohen të dërgohen propozime kumtesash (200 fjalë) në adresat: brikena.smajli@unishk.edu.al dhe emilio.gallardo@csic.es, deri më 30 qershor 2026. Kumtesat e përzgjedhura duhet të kenë kohëzgjatje jo më shumë se 20 minuta.
- ▶ Ata që dëshirojnë të marrin pjesë si dëgjues mund të regjistrohen në: brikena.smajli@unishk.edu.al dhe emilio.gallardo@csic.es.
- ▶ Gjuhët e simpoziumit janë shqip, spanjisht dhe anglisht.
- ▶ Pjesëmarrja është pa pagesë.

Gjatë periudhës socialiste, letërsia e huaj luajti një rol të dyfishtë: në disa raste, ajo ndihmoi në përforcimin e roleve të ngushta krijuese të imponuara nga pushteti politik dhe ai politik-kulturor; ndërsa, në të tjera, e lehtësoi qasjen në realitete të ndryshme të huaja, në stile të tjera letrare, madje edhe shërbeu si urë që disa shkrimtarë të mund të binin në kontakt me *fusha kulturore* jashtë vendit dhe të projektoheshin përtej kufijve shqiptarë. Për të analizuar rolin e letërsisë së huaj në këtë kontekst historik, këshillohet të merren parasysh një shumësi aktorësh individualë dhe institucionalë (shkrimtarë, përkthyes, kritikë, shtëpi botuese, Lidhja, etj.), si edhe një vështrim i gjerë nga pikëpamja gjuhësore.

Në këtë kuptim, edhe pse ky simpozium është një rezultat i lidhur drejtpërdrejt me projektin *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II (ELASOC II)*, organizatorët dëshirojnë të ftojnë ekspertë jo vetëm të letërsisë së shkruar në spanjisht, por edhe të letërsive në gjuhë të tjera, të cilat u përfshinë në *fushën kulturore* shqiptare përmes përkthimeve. Për këtë arsye, propozojmë këto linja pune:

1. Tryezë e posaçme mbi recepsionin e letërsisë në spanjisht dhe portugalisht (Spanjë dhe Amerikë Latine).
2. Recepsioni i letërsisë së bllokut socialist.
3. Recepsioni i letërsisë së bllokut perëndimor.
4. Sistemi botues shqiptar: mekanizmat e importimit, prodhimit dhe kontrollit.
5. Roli i kritikës.
6. Roli i përkthyesve.
7. Dialogë dhe ndikime ndërmjet krijimtarisë në shqip dhe letërsisë së huaj.
8. Roli i institucioneve kulturore: Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, etj.

Komiteti organizues:

Brikena Smajli (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Shqipëri).
Emilio J. Gallardo Saborido (Shkolla e Studimeve Hispano-Amerikane/ Instituti i Historisë, CSIC, Sevilje, Spanjë).
Xherardo Nikjari (Muzeu: Vendi i Dëshmisë dhe i Kujtesës, Shkodër, Shqipëri).

Esta actividad es resultado del proyecto *Escritores latinoamericanos en los países socialistas europeos durante la Guerra Fría. Fase II (ELASOC II)*, PID2023-149252NB-I00) financiado por MICIU/AEI/10.13039/501100011033 y por FEDER, UE

Proyecto PID2023-149252NB-I00 financiado por:



MINISTERIO
DE CIENCIA, INNOVACIÓN
Y UNIVERSIDADES



Cofinanciado por
la Unión Europea



AGENCIA
ESTATAL DE
INVESTIGACIÓN



CSIC
CONSEJO SUPERIOR DE INVESTIGACIONES CIENTÍFICAS



INSTITUTO DE
HISTORIA



EEHA
ESCUOLA DE ESTUDIOS
HISPANO-AMERICANOS

